



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:176929

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05433691

C.nr.275/2020

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avdulla Mecinaj, në çështjen kontestimore të paditëses B.Sh. nga fshati..., komuna Skenderaj, te cilën e përfaqëson sipas autorizimit Q.R. avokat ne Skenderaj, kundër të paditurës B... ne Prishtinë, Rr..., te cilën me autorizim e përfaqësoi Sh.R. nga k... Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, pas *përfundimit* te seancës kryesore publike me dt.15.02.2024, jep këtë.

A K T G J Y K I M

I. Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditëses B.Sh. nga fshati..., komuna Skenderaj, si e bazuar.

II. Detyrohet e paditura B... me seli Prishtinë, që në emër të kompensimit për aksidentin e dt.05.06.2020 t'i paguaj paditëses B.Sh.:

Për dëmin jomaterial:

për dhimbje trupore- fizike shumen prej -----1200 €,
për frike shumen prej-----1000 €,

Në shumë të përgjithshme prej 2200 € me kamatë ligjore 8%, nga dita e gjykimit 15.02.2024 e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për dëmin material:

për ndihmën nga personi tjetër shumen prej-----75 €,
për ushqim të përforcuar shumen prej -----180 €,
për rehabilitimin fizikal shumën prej -----105 €,
për shpenzimet e shërimit mjekësore shumen prej -----112 €,

Në shumë të përgjithshme prej 472 € me kamatë ligjore 8%, nga dita e parashtrimit të padis e dt.02.07.2020 e deri ne pagesën definitive ne afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë në me tepër se shumat e gjykuara si në piken II si e pabazuar.

IV. Obligohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguaj shumën prej 799 €, në afat prej 15 dite, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

V. Obligohet paditësi që ta paguaj diferencën e taksës gjyqësore në shume prej 20 euro, pasi që janë paguar vetëm 20 euro, në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja B.Sh. përmes të autorizuarit ka parashtruar padi në këtë gjykatë me dt.02.07.2020, kundër të paditurës B..., me seli në Prishtinë, për kompensimin e demit material dhe jomaterial që ka pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale në aksidentin e trafikut rrugor me dt.05.06.2020 në rrugën... në Skenderaj.

E paditura ka paraqitur përgjigje në padi me propozim që kërkesëpadija e paditësit të aprovohet pjesërisht.

I autorizuari i paditëses në seancën kryesore deklaroi se me provat e administruara u vërtetua baza juridike e kërkesë padisë, e cila nuk është kontestuese nga e paditura në lidhje me gjendjen faktike, u vërtetua drejt gjendja nga ekspertiza mjekësore dhe konform kësaj e kemi bere precizimin e kërkesë padisë me parashtrësën e dt:15.02.2024 dhe plotësimin e saj në këtë seance duke shtuar edhe kategorinë në emër të demit material për shërimin mjekësor- kuponët fiskal shumen prej 112 euro dhe i propozim gjykatës që ta aprovoi kërkesë padinë në shumen e precizuar prej 5562 euro me kamat ligjore 8% nga marrja e aktgjykimit për demin jo material ndërsa për demin material nga data e parashtrimit të padisë 02.07.2020 e deri në pagesën definitive, me propozim gjykatës që të aprovohet kërkesë padia si e bazuar.

I kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore të precizuara në parashtrësë në shumë prej 799 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancat gjyqësore nuk e kontestoj bazën juridike të kërkesëpadiës, por e kundërshtoj lartësinë e dëmshpërblimit të precizuar nga i autorizuari i paditësit për nga lartësia e demit, pasi që bazuar në ekspertiza mjekësore dhe raporteve tjera mjekësore paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, andaj shumat e kërkuara nga paditësi janë tepër të larta dhe të pabazuara.

Gjykata me propozimin e palëve si prova administroi: raporti i aksidentit nr.2020-BR-288 i dt.05.06.2020, raporti mjekësor të dt.05.06.2020 lëshuar nga spitali i përgjithshëm –Emergjenca në Mitrovicë, raporti mjekësor i ordinancës specialistike –ortopedike dhe ekspertiza mjekësore C.nr.275/2020 e dt:23.01.2024,

Në kuptim të nenit 8 të Ligji i Procedurës Kontestimore, pas analizimit dhe vlerësimit të gjithanshëm të deklaratave të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se aksidenti ka ndodhur me dt.05.06.2020 në rrugën... në Skenderaj.

Në mes palëve në procedurë baza juridike e kërkesëpadiës nuk është kontestuese, ndërsa kontestuese janë shumat e kërkuara për dëmshpërblim për të cilat i autorizuari i paditësit pretendon se janë të arsyeshme dhe reale, ndërsa e paditura konsideron se bazuar në lëndimet dhe demet që ka pësuar paditësi janë teje të larta dhe jo në harmoni me praktiken gjyqësore.

Ne ekspertizën e hartuar me shkrim C.nr.275/2020 e dt:23.01.2024 nga ekspertet gjyqësore Dr.V.B. ortopedë traumatologë dhe Dr.V.R.B.- psikiatër, duke u bazuar në dokumentacionin mjekësorë dhe ekzaminimin e drejt për drejt të palës paditëse kanë dhënë mendimin profesional se paditësja me rastin e aksidentit të trafikut ka pësuar ndrydhje e regjionit të kokës, ndrydhje e regjionit të qafës, ndrydhje e regjionit të trupit, të cilat lëndime truporë kategorizohen si lëndime të lehta trupore dhe si pasojë e tyre paditësja ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit të rendit 24 ore, të intensitetit të mesëm 18 dite, dhe të intensitetit të ultë edhe për 30 dite të tjera, frikë primare ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 24 ore, frikë sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur edhe për 4 javë, frikë sekondare e intensitetit të ultë e dëmtuara përjeton ende, shëmtim trupor nuk ka, zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka, ndihma e personit të tret ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 5 dite, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 dite, dhe rehabilitimi fiziko-terapeutik ka qenë i nevojshëm për 7 ditë pas aksidentit.

Konstatimin dhe mendimin e eksperteve gjyqësorë nga lomia e mjekësisë palët ndërgjyqëse në procedurë nuk e kontestuan, i cili për gjykatën u konsiderua se është i dhënë në mënyrë profesionale dhe shkencore, prandaj i falë edhe besimin e plotë.

Me rastin e vlerësimit në lartësinë e dëmit jomaterial dhe material, gjykata pati parasysh natyrën e lëndimeve trupore që ka pësuar paditësi dhe moshën e paditësit e duke u bazuar në nenin 183 të LMD të Kosovës, në të cilin është përcaktuar se për dhimbje të pësuar fizike, për dhimbjet e përjetuara shpirtërore gjykata do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla.

Me nenin 10 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia është përcaktuar se kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e LMD.

Pjesa e kërkesëpadisë në emër të përkuqdesjes nga personi tjetër, ushqimit të përforcuar dhe rehabilitimit konsiderohet si e arsyeshme dhe gjykata me bindje të lirë e aprovoi këtë pjesë të kërkesëpadisë duke u bazuar në kushtet dhe standardin jetësor në Kosovë, e në kuptim të nenit 323 të LPK të Kosovës.

Shumat e aprovuara në emër të dëmshpërblimit për dëmit jomaterial dhe material janë të arsyeshme e që paraqesin një satisfakcion që paditësi me këto mjete t'i riparojë në një masë nevojat e veta materiale e që për ndryshe nuk paraqesin kompensim absolut të dëmshpërblimit.

Pjesa e kërkesëpadisë se precizuar mbi shumën e gjykuar në lartësi të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është refuzuar si e pabazuar si shumë e cila tejkalon arsyshmërinë e kompensimit.

Gjykata në lartësinë e aprovuar si në dispozitiv paditësit ia njohu të drejtën me kamatë ligjore të cilën e paditura duhet ta përmbushi në kuptim të neneve 382 dhe 378 të LMD të Kosovës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore u bazua në nenin 452 të LPK, në të cilat shpenzime janë llogaritur për hartimin e padisë shumë prej 104 euro, taksa gjyqësore për padi shumë 40 euro, për precizimin e kërkesëpadisë shumë 104 euro, për dy ekspertiza mjekësore 300 euro, dhe për dy përfaqësime në seanca 270 euro, e në shumë të përgjithshme 819 euro.

Gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:176929
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05433691

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
C.nr.275/2020 me dt.15.02.2024

Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së aktgjykimit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.